



FJALA E ATIT TE SHENJTE FRANÇESK DREJTUAR PJESEMARRESVE NE KONGRESIN E FORUMIT NDERKOMBETAR TE AKSIONIT KATOLIK (FNAK)

Salla e Sinodit - E enjte 27 prill 2017



FJALA E ATIT TE SHENJTE FRANÇESK PER AKSIONIN KATOLIK ITALIAN

Sheshi Shën Pjetri - E djelë, 30 prill 2017

E enjte 27 prill 2017

Të dashur vëllezër e motra,

Ju përshëndes me rastin e kremtimit të këtij Kongresi ndërkombëtar të Aksionit Katolik, që ka si temë: “ Aksioni Katolik është mision. Me të gjithë, për të gjithë”. Do të më pëlqente të ndaja me ju ca shqetësime e vlerësime.

Karizma – rikrijim nën dritën e *Evangelii gaudium*

Historikisht Aksioni Katolik ka patur si mision Formimin e laikëve që do të merrnin përgjegjësinë e tyre nëpër botë. Sot, konkretisht, *është formimi i dishepujve misionarë*. Ju faleminderit që e keni bërë *Evangelii gaudium* me vendosmëri, Kartën tuaj të Madhe.

Karizma e Aksionit Katolik është karizma e vetë Kishës së mishëruar thellë në të sotmen dhe në vendin e këtushëm të çdo Kisha dioqezane që kqyr në kundrim e me vështrim të vëmendshëm jetën e popullit të vet dhe kërkon udhë të reja ungjillizimi dhe misioni duke u nisur nga realitetet e ndryshme famullitare.

Aksioni Katolik ka patur tradicionalisht 4 shtylla ose putra: *Lutjen, Formimin, Sakrificën dhe Apostullatën*. Sipas momentit të historisë së vet, ka vendosur njëherë njëren putër e pastaj të tjerat. Kështu, në një farë momenti, ka qenë më e fortë lutja ose formimi doktrinal. Duke parë karakteristikat e momentit, apostullata duhet të jetë tipari dallues dhe është putra që hidhet e para. Dhe kjo nuk shkon në dëm të realiteteve të tjera, por, përkundrazi, i nxit të tjerat. Apostullata misionare ka nevojë për lutje, formim e sakrificë. Kjo duket qartë te *Aparecida* dhe tek *Evangelii gaudium*. *Ka dinamizëm integrues te misioni*.

Formoni: duke ofruar një proces pjekurie në besim, një udhë katekizmi të drejtuar gjithmonë nga misioni, të përshtatshme me çdo realitetet, ku ju të bazoheni te Fjala e Hyut, për t'i dhënë jetë një miqësie të lumtur me Jezusin dhe përvojës së dashurisë vëllazërore.

Lutuni: në atë daljen e shenjtë jashtë vetes për të vendosur zemrën te nevojat e popullit, në vuajtjet e në gëzimet e tij. Një lutje që të ecë, që t'ju shpjerë shumë larg. Kështu s'do mbeteni duke parë vazhdimisht veten tuaj.

Sakrifikohuni: por jo për t'u ndjerë më të pastër; sakrifica bujare është ajo që iu bën mirë të tjerëve. Ofrojeni kohën tuaj duke kërkuar çfarë të bëni që të tjerët të rriten, ofroni atë që keni në xhepa duke e ndarë me ata që kanë më pak, ofroni bujarisht dhuntinë e vokacionit tuaj vetjak për ta zbukuruar e për ta rritur *shtëpinë e përbashkët*.

Ripërtëritje e angazhimit: ungjillizues- dioqezë-famulli

Misioni nuk është një detyrë ndër të shumtat e Aksionit Katolik, ai është *Detyra*. Aksioni Katolik ka karizmën e çuarjes përpara të pastorales së

Kishës. Nëqoftëse misioni nuk është forca e tij dalluese, thelbi i Aksionit Katolik çnatyralizohet dhe e humbet arësytën e ekzistencës së vet.

Është jetike ripërtëritja dhe përditësimi i angazhimit të Aksionit Katolik për ungjillizimin, duke mbërritur te të gjithë, në çdo vend, në të gjitha rastet, në të gjitha skajet e jetueshme, me të vërtetë, e jo si formulim i thjeshtë parimesh.

Kjo nënkupton që *t'i rimendoni planet tuaja të formimit, format tuaja të apostullatës madje dhe vetë lutjen tuaj, me qëllim që ato të jenë thelbësisht, e jo me raste, misionare. Braktiseni kriterin e vjetër: se gjithmonë kështu është bërë.* Ka gjëra që me të vërtetë kanë qenë të mira e me merita, por që sot do të ishin jashtë konteksti nëse do të donim t'i përsëritnim.

Aksioni Katolik duhet ta bëjë të vetën *tërësinë e misionit të Kishës në përkatësi bujare të Kishës dioqezane duke nisur nga Famullia.*

Misioni i Kishës universale përditësohet në çdo Kishë të veçantë me ngjyrën e vet; po ashtu Aksioni Katolik fiton jetë autentike duke u përgjigjur e duke e bërë të vetën *pastoralen e çdo Kise dioqezane në futjen e saj konkrete duke filluar nga famullitë.*

Aksioni Katolik duhet t'i ofrojë Kishës dioqezane një laikat të pjekur që *t'u shërbejë me gatishmëri projekteve pastorale* të çdo vendi si një mënyrë për të realizuar vokacionin e vet. Duhet të mishëroheni konkretisht.

Nuk mund të jeni si ato grupet *shumë* universale që nuk kanë një bazë në asnjë vend, që nuk i përgjigjen askujt dhe shkojnë e kërkojnë çka iu pëlqen më tepër nga çdo vend.

VEPRUES – Të gjithë pa përjashtim

Të gjithë anëtarët e Aksionit Katolik janë *misionarë në mënyrë dinamike.* Fëmijët ungjillizojnë fëmijët, të rinjtë të rinjtë, të rriturit të rriturit e kështu

me radhë. Ku ka më bukur se një i barabartë me ty që të tregon se është e mundur ta jetosh gëzimin e besimit.

Shmangeni rënien në *tundimin e përsosmërisë së përgatitjes së përjetshme* për misionin dhe të *analizave të përjetshme*, që, kur mbyllen, kanë dalë mode apo janë lënë prapa. Shembulli i Jezusit me apostujt: i dërgonte me atë çka kishin. Pastaj i mbliidhte e i ndihmonte të reflektonin mbi ato që kishin përjetuar.

Le të jetë realiteti ai që ju dikton kohën; le ta lini Shpirtin e Shenjtë t'ju udhëheqë. Ai është mësuesi i brendshëm që ndriçon veprimtarinë tonë kur jemi të lirë nga paragjykimet dhe kushtëzimet. Ungjillizimi mësohet duke ungjillizuar, ashtu siç mësohet lutja duke u lutur, nëse zemra jonë është e hapur për këtë.

Të gjithë mund të shkoni në mision edhe pse jo të gjithë mund të dilni nëpër rrugë apo nëpër fusha. Është shumë i rëndësishëm vendi që iu jepni të moshuarve që janë anëtarë prej një kohe të gjatë apo që bashkohen. Mund të thuhet: mund të jenë *seksioni kundruës dhe ndërmjetësues* brenda seksioneve të ndryshme të Aksionit Katolik. Janë ata që mund ta krijojnë pasurinë e lutjes dhe hirit për misionit. Ashtu si dhe të sëmurët. Këtë lutje Hyu e dëgjon me dhembshuri të veçantë. Të gjithë ata u ndjefshin pjesëmarrës, u zbulofshin aktivë e të nevojshëm.

Të destinuarit – Të gjithë njerëzit e të gjitha periferitë.

Është e nevojshme që Aksioni Katolik të jetë i pranishëm *në botën politike, në biznes, në botën profesionale*, por jo sepse e mbajmë veten për të krishterë të përsosur e të formuar, por për të shërbyer më mirë.

Është e domodsoshme që Aksioni Katolik të jetë i pranishëm *nëpër burgje, nëpër spitale, në rrugë, në lagjet me barraka, nëpër fabrika*. Po të mos jetë kështu, do të jetë një institucion *përrjashtuesish* që s'ka kuptim për askënd, as për vetë Kishën.

Dua një Aksion Katolik në mes njerëzve, në famulli, në dioqezë, në qytet, në lagje, në familje, në shkollë e në punë, në fushë, në të gjitha sferat e jetës. Pikërisht në këto aeropage të reja merren vendimet e ndërtohet kultura.

Mpreheni mënyrën e integritit. Mos u bëni si dogana. Nuk mund të jeni ju më kufizues se vetë Kisha, e as më papistë se Papa. Hapini portat, mos bëni provime të përsosmërisë së krishterë sepse po bëtë kështu, do të zhvilloni fariseizmin hipokrit. Ka nevojë për bamirësi aktive.

Detyra që marrin përsipër laikët që antarësohen në Aksionin Katolik shikon përpara. Është vendimi për të punuar për ndërtimin e mbretërisë. Nuk duhet “burokratizuar” ky hir i veçantë sepse ftesa e Zotit vjen atëherë kur nuk e presim; ama nuk mundemi as ta “bëjmë sakrament” zyrtarizimin me kërkesa që i përgjigjen një fushe tjetër të jetës së fesë e jo asaj të detyrës ungjillizuese. Të gjithë kanë të drejtë të jenë ungjillizues.

Aksioni Katolik le t’iu ofrojë hapsirën e mikpritjes e të *përvojës së krishterë* atyre që, për arësye personale, ndjehen “ të krishterë të dorës së dytë”.

Mënyra- mes popullit

Mënyra varet nga përfituesi. Siç na ka thënë Koncili dhe lutemi shpesh në Meshë: duke marrë pjesë në betejat dhe shpresat e njerëzve për t’iu treguar atyre udhën e shpëtimit. Aksioni Katolik *nuk mund të qendrojë larg nga populli*, por vjen nga populli e duhet të qendrojë në mes popullit. Duhet ta popullarizoni më shumë Aksionin Katolik. Nuk është çështje imazhi por vërtetësie dhe karizme. Nuk është as demagogji, por ndjekje e hapave të Mësuesit që nuk ndjeu neveri për asgjë.

Që të mund ta ndjekim këtë rrugë është mirë të lagemi në “*detin*” e popullit. Të bëjmë jetën e njerëzve dhe të mësojmë të zbulojmë cilat janë interesat dhe përpjekjet e tyre, cilat janë aspiratat e tyre dhe plagët e tyre

më të thella; dhe për çfarë ka nevojë nga ne. Kjo është themelore për të mos rënë në *sterilitetin e dhënies së përgjigjeve ndaj pyetjeve që s'i bën askush*. Mënyrat e ungjillizimit mund të mendohen nga tavolina, por vetëm pasi kemi qenë në mes të popullit, e jo nga e kundërta.

Një Aksion Katolik më popullor, më i mishëruar, *do t'ju shkaktojë probleme*, sepse do të duan të marrin pjesë në institucion persona që në dukje *nuk janë në gjendje për këtë*: familje ku prindërit s'janë martuar në Kishë, burra e gra me nje të shkuar apo të tashme të vështirë, por që luftojnë, të rinj të çorientuar e të plagosur. Është një sfidë për *amësinë* kishëtare të Aksionit Katolik; t'i mirëpresim të gjithë e t'i shoqërojmë në rrugën e jetës me kryqet që mbajnë mbi supe.

Të gjithë mund të marrin pjesë *duke nisur nga ajo që kanë e ajo që munden*.

Për këtë popull konkret formohemi. Me këtë popull e për këtë popull konkret lutemi.

Mpreheni shikimin për të parë *shenjat e Hyut të pranishme në realitet, veçanërisht në shprehjet e fetarisë popullore*. Prej aty mund ta kuptoni më mirë zemrën e njerëzve e do të zbuloni mënyrat e befasishme me të cilat Hyu vepron përtej koncepteve tona.

Projekti – Aksion Katolik në dalje – Pasion për Krishtin, pasion për popullin tonë

I keni vënë vetes si qëllim një Aksion Katolik në dalje, dhe kjo është një gjë e mirë sepse ju vendos mbi boshtin e vetes suaj. Dalje do të thotë hapje, bujari, takim me realitetin përtej katër mureve të institucionit dhe famullive. Kjo do të thotë *të heqësh dorë nga kontrolli i tepërt i gjërave dhe nga programimi i rezultatit*. Pikërisht kjo liri është fruti i Shpirtit të Shenjtë, që do t'ju bëjë të rriteni.

Projekti ungjillizues i Aksionit Katolik duhet të kryejë hapat e mëposhtëm: *primerear*, pra, të marrësh iniciativën, të marrësh pjesë, të shoqërosh, të japësh frut e të festosh. Një hap para në dalje, të mishëruar e duke ecur së bashku. Ky është tanimë një frut që duhet festuar. *Ngjituani të tjerëve gëzimin e besimit*, që të vihet re gëzimi i ungjillizimit në çdo rast, të përshtatshëm e të papërshtatshëm.

Mos bini në tundimin e *strukturalizmit*. Jini guximtarë; nuk jeni më besnikë ndaj Kishës nëse prisni në çdo hap t'ju thonë çfarë duhet të bëni.

Inkurajojini antarët tuaj që ta vlerësojnë *misionin trup me trup* të rastësishëm apo duke nisur nga aksioni misionar i komunitetit.

Mos e klerikalizoni laikun. Aspirata e anëtarëve tuaj të mos jetë pjesëmarrja në sinedrinë e famullive që rrethon famullitarin, por pasioni për mbretërinë. Mos harroni ama ta *vendosni temën e thirrjes* me seriozitet. Shkollë shenjtërie që kalon detyrimisht nga zbulimi i thirrjes sonë, që nuk është ajo e të qenit drejtues apo prift i diplomuar, por, para së gjithash: *Ungjillizues*.

Duhet të jeni vend takimi karizmat e tjera institucionale e lëvizjet që janë në Kishë, pa patur frikë se humbisni identitetin. Përveç kësaj, mes anëtarëve tuaj duhet të dalin ungjillizues, katekistë, misionarë, operatorë socialë që do të vazhdojnë ta bëjnë Kishën të rritet.

Shumë herë është thënë se Aksioni Katolik është *krahu i gjatë i hierarkisë dhe kjo*, larg të qenit karakteristikë që të bën t'i shohësh të tjerët nga lart poshtë, është një përgjegjësi shumë e madhe që nënkupton besnikëri e koherencë me atë që Kisha tregon në çdo moment të historisë, pa pretenduar të rrini të varur mbas formave të shkuara, si të ishin ato të vetmet e mundshme. Besnikëria ndaj misionit e kërkon këtë "Plasticitet të mirë" të atij që e ka kthyer një vesh nga populli e një nga Hyu.

Në botimin "Aksioni Katolik nën dritën e teologjisë Tomiste", të vitit 1937, lexohet: "Ndoshta Aksioni Katolik a nuk duhet përkthyer në Pasion

Katolik?”. Pasioni katolik, pasioni i Kishës është të jetuarit e gëzimit të ëmbël e çlodhës të ungjillizimit. Kjo është ajo për të cilën kemi nevojë nga Aksioni Katolik.

Faleminderit.

FJALA E ATIT TE SHENJTE FRANÇESK PER AKSIONIN KATOLIK ITALIAN

*Sheshi Shën Pjetri
E djelë, 30 prill 2017*

Të dashur miq të Aksionit Katolik, mirëdita!

Jam me të vërtetë i lumtur që ju takoj sot, kaq të shumtë në numër e në festë për 150 – vjetorin e themelimit të Shoqatës suaj, Ju përshëndes të gjithëve me dashuri duke filluar nga Asistenti i përgjithshëm e nga Presidenti kombëtar, që i falenderoj për fjalët me të cilat bënë hyrjen e këtij takimi. Lindja e Aksionit Katolik Italian ishte një ëndërr , lindur nga zemra e dy të rinjve, Mario Fani dhe Xhovani Akuaderni, që bë gjatë kësaj kohe një udhë e besimit për shumë breza, thirrje për shenjtëri për persona të shumtë: fëmijë, të rinj e të rritur që u bënë dishepuj të Jezusit dhe, për këtë, provuan të jetojnë si dëshmitarë të gëzueshëm të dashurisë së tij nëpër botë. Edhe për mua është pak si të jem në familje: babai im, gjyshja ime, ishin të Aksionit katolik!

Është një histori e buur dhe e rëndësishme, për të cilën keni shumë arsye për t'i qenë mirënjohës Zotit e për të cilat Kisha është mirënjohëse ndaj jush. Është historia e një populli të formuar nga burra e gra të çdo moshe e klase, që u vunë në provë mbi dëshirën për të jetuar së bashku takimin me Zotin: të vegjël e të mëdhenj, laikë e priftërinj, së bashku, pavarësisht nga pozita shoqërore, nga përgatitja kulturore, nga vendi i origjinës. Besimtarë laikë që në të gjitha kohërat kanë ndarë së bashku kërkimin e rrugëve mes të cilave ta kumtonin me jetën e tyre bukurinë e dashurisë së Hyut e të kontribuonin, me angazhimin e tyre dhe aftësitë e tyre, në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, më vëllazërore, më solidare. Është një histori pasioni për botën e për Kishën – më kujtohet kur ju fola për një libër të shkruar në

Argjentinë në 1937 që thoshte: “Aksioni katolik është Pasion katolik”!- e brenda kësaj historie janë rritur figura ndriçuese burrash e grash me fe shembullore, që i kanë shërbyer Atdheut me bujari e kurajo.

Pasja e një historie të bukur prapa vetes nuk na shërben ama për të ecur me sytë prapa, nuk shërben për t’u parë në pasqyrë, nuk shërben për t’u ulur rehat në kolltuk! Mos e harroni këtë: Mos ecni me sytë mbrapa se do përplaseni! Mos u shihni në pasqyrë! Shumë prej nesh, jemi të shëmtuar, më mirë mirë të mos shihemi! E mos u rehatoni në kolltuk, se do dhjamoseni dhe ju bën keq për kolesterolin! Përkujtimi i një udhe të gjatë jete na ndihmon të bëhemi të vetëdijshëm se jemi një popull që ecën duke u kujdesur për të gjithë, duke e ndihmuar secilin të rritet si njeri e të rritet në besim, duke shpërndarë mëshirimin me të cilin Zoti na përkëdhel. Ju inkurajoj të vazhdoni të jeni një popull dishepujsh-misionarë që jetojnë e dëshmojnë gëzimin e vetëdijes se Zoti na do me një dashuri të pafund, e se bashkë me Të e duam thellë historinë ku jetojmë. Kështu na kanë mësuar dëshmitarët e mëdhenj të shenjtërisë që kanë hedhur trasenë e rrugës së shoqatës suaj, mes të cilëve më pëlqen të kujtoj Xhuzepe Toniolo, Armida Bareli, Pierxhorxho Frasati, Antonieta Meo, Terezio Oliveli, Vittorio Bashlé.

Aksion katolik, jeto në lartësinë e historisë sate! Jeto në lartësinë e këtyre grave e burrave që të kanë paraprirë!

Në këto njëqind e pesëdhjetë vjet Aksioni Katolik është karakterizuar gjithmonë nga një dashuri e madhe për Jezusin dhe për Kishën. Edhe sot jeni thirrur ta vazhdoni thirrjen tuaj të veçantë duke u venë në shërbim të dioqezave, rreth Ipeshkëvinjve- gjithmonë-, e nëpër famulli- gjithmonë – atje ku Kisha banon në mes njerëzve – gjithmonë.

I gjithë Populli i Hyut gëzon frytet e këtij dedikimit tuaj, jetuar në harmoni mes Kishës universale dhe Kishës së veçantë. Pikërisht te thirrja tipike e laikut për një shenjtëri të jetur përditë mund ta gjeni forcën dhe kurajon për ta jetuar besimin duke mbetur aty ku jeni, duke e bërë mikpritjen dhe bashkebisedimin stilin me të cilin të bëheni të afërt me njeri-tjetrin, duke eksperimentuar bukurinë e përgjegjësisë së përbashkët. Mos u lodhni së

përshkuari udhë nëpër të cilat mund ta rritni stilin e një sinodialiteti të mirëfilltë, një mënyrë për të qenë Popull i Hyut në të cilin kushdo mund të kontribuojë në një lexim të vëmendshëm, të medituar, që flet për shenjat e kohërave, për ta kuptuar e jetuar vullnetin e Hyut, të sigurt se aksioni i Shpirtit të Shenjtë vepron dhe i ben të reja çdo ditë të gjitha gjërat.

Ju ftoj ta çoni përpara përvojën tuaj apostolike me rrënjët te famullia, “ e cila nuk është një strukturë shteruese” – e kuptuat mirë? Famullia nuk është një strukturë shteruese! - , sepse është prani kishëtare në territor, fushë e dëgjimit të Fjalës, e rritjes së jetës së krishterë, e dialogut, e lajmërimit, e mëshirës bujare, e adhurimit dhe e kremtimit” (Esort. Ap. Evangeliu gaudium, 28). Famullia është hapsira ku njerëzit mund të ndjehen të mirëpritur ashtu siç janë, e mund të shoqërohen mes udhëve të pjekurisë njerëzore e shpirtërore e të rriten në besimin e në dashurinë për krijesën e për vëllezërit. Kjo është e vërtetë ama, vetëm nëse famullia nuk mbyllet në vetvete, edhe nëse Aksioni Katolik që jeton në famulli nuk mbyllet në vetvete, por e ndihmon famullinë të mbetet në “kontakt me familjet e me jetën e popullit e të mos bëhet strukturë e stërzgatur, e ndarë nga njerëzit apo një grup të zgjedhurish që shohin veten e tyre” (ibid). Ju lutem, kështu jo!

Të dashur anëtarë të Aksionit Katolik, çdo iniciativë e juaja, çdo propozim, çdo ecje, qoftë përvojë misionare, e destinuar për ungjillizimin, e jo për vetëruajtje. Përkatësia juaj ndaj dioqezës e famullisë u mishëroftë përgjatë rrugëve të qyteteve, të lagjeve e të fshatrave. Ashtu siç ka ndodhur në këto 150 vjet: ndjejeni fort brenda vetes suaj përgjegjësinë e hedhjes së farës së mirë të Ungjillit në jetën e botës, përmes shërbimit të bamirësisë, angazhimit politik, - futuni në politikë, por ju lutem, në politikën e madhe, në Politikën me germë të madhe! – edhe përmes pasionit edukues dhe pjesëmarrjes në ballafaqimin kulturor. Hapeni zemrën tuaj për të hapur zemrën e famullive tuaja. Jini udhëtarë të fesë, për t’i takuar të gjithë, për t’i mirëpritur të gjithë, për t’i dëgjuar të gjithë, për t’i përqafuar të gjithë. Çdo jetë është e dashur për Zotin, çdo fytyrë na tregon fytyrën e Krishtit, veçanërisht atë të të varfrit, të atij që është i plagosur nga jeta e të atij që

ndjehet i braktisur, të atij që i druhet vdekjes e kërkon strehë mes shtëpive tona, në qytetet tona. “Askush nuk mund të ndjehet i çliruar nga shqetësimi për të varfërit e për drejtësinë shoqërore” (ibid., 201).

Qendroni të hapur ndaj realitetit që ju rrethon. Kërkoni pa druajtje dialogun me kë jeton pranë jush, edhe me kë mendon ndryshe nga ju por ashtu si ju dëshiron paqe, drejtësi e vëllazërim. Tek dialogu mund të projektohet një e ardhme e ndarë me të tjerët. Përmes dialogut nderojmë paqen, kujdesemi për të gjithë dhe bisedojmë me të gjithë.

Të dashur fëmijë, të rinj e të rritur të Aksionit Katolik: shkoni, mbrini në të gjitha skajet e periferive! Shkoni e atje bëhuni Kisha, me forcën e Shpirtit të Shenjtë!

Ju mbeshettë mbrojtja amësore e Virgjërës së Papërlyer; ju shoqërofshin inkurajimi e vlerësimi i Ipeshkëvinjve; ashtu si dhe Bekimi im që nga zemra jap sot mbi ju e mbi mbarë Shoqatën. Dhe ju lutem, mos harroni të luteni për mua!